

Libër informativ për të burgosurit me paaftësi



**Ky libër ju jep informacione rreth
jetës në burg dhe se ku mund të
kërkoni ndihmë për t'i bërë gjërat**

Copyright information

© Offender Health and Prison Reform Trust 2009

This publication can be shared copied distributed and transmitted but not sold. It can not be altered in any way without the permission of the copyright owners.

First published in 2004 by the Prison Reform Trust kindly supported by Lloyd's Charities Trust
This edition published in 2009 by the Prison Reform Trust kindly supported by the Hadley Trust and Offender Health.

Many thanks to the following for their help with this booklet:

- Mencap, Her Majesty's Inspectorate of Prisons, Cloisters, Race Equality Action Group and all the disability liaison officers and other prison staff who commented on the draft
- staff and prisoners at HMP Birmingham, HMP Downview, HMP Feltham and HMP Leyhill for their help with focus groups
- Offender Health and PRT staff for content, photos and design

Çfarë ka në këtë libër?

	Faqja
Si të merrni ndihmën që ju nevojitet në burg	4
Kujt t'i kërkoni ndihmë	5
Çfarë mund të bëni nëse	
• ndiheni i mërzitur apo i shqetësuar. Apo dikush ju trajton keq	6
• e keni të vështirë ta kuptoni informacionin	7
• e keni të vështirë t'i bëni gjërat në burg	7
• nuk jeni të kënaqur me diçka në burg	8
• ndiheni i sëmurë apo duhet të merrni ilaçe	9
Gjëra të tjera me të cilat mund të keni nevojë për ndihmë	10
Jeta pas burgut	12

Ku mund ta merrni këtë libër

- Nëse nuk keni një kopje tuajën të këtij libri, kërkojini punonjësit tuaj personal (personal officer) ose oficerit ndërlidhës për të paaftët (disability liaison officer (DLO)) t'ju japë një kopje.
- Disa nga informacionet mund t'i kërkoni në CD.

- Shkruajini “Prison Reform Trust, FREEPOST ND6125, London EC1B 1PN”.

Mbi çfarë është ky libër?

- Shumë njerëz në burg kanë paaftësi të tilla si otizëm, azëm ose depresion.
- Ky libër është për të burgosurit të cilët vuajnë nga paaftësi.
- Ju jep informacione të rëndësishme rreth jetës në burg dhe se çfarë ndihme mund të merrni.
- Ekziston një libër tjetër i quajtur “Information Book for Prisoners with a Disability” (vetëm në anglisht) të cilin mund ta kërkontë dhe ta shikoni. Ju informon më shumë se sa ky libër.

Si të merrni ndihmën që ju nevojitet në burg

- Është mirë që t'i thoni personelit të burgut sa më shpejt që të jetë e mundur nëse keni një paaftësi ose nëse keni nevojë për ndihmë që të bëni diçka.
- Personeli i burgut **duhet** të bëjë gjithçka të mundur që t'ju japë ndihmën që ju nevojitet. Ligji përcakton se ata duhet ta bëjnë këtë gjë.
- Personeli i burgut do ta mbajë të fshehtë atë që thoni.

Çfarë ndihme duhet t'ju japë personeli i burgut?

Personeli i burgut duhet t'ju japë të gjithë ndihmën që ju nevojitet që të jeni pjesë e jetës në burg.

Personeli i burgut duhet t'ju japë ndihmën që kërkonti

- për të kuptuar informacionin ose atë që ju thonë njerëzit
- për të punuar apo ndjekur edukimin (edukimi është kur ju mësoni gjëra të reja)
- që të mbaheni në kontakt me familjen dhe miqtë tuaj
- që të jeni të shëndetshëm

Kujt t'i kërkonti ndihmë në burg

Personat kryesorë të cilëve mund t'i kërkonti ndihmë janë

1

Oficerët e burgut (prison officers) ose oficeri juaj personal (personal officer)

Flisni me oficerët e burgut për çdo pyetje që keni ose për çdo gjë që ju nevojitet ndihmë.

2

Oficeri ndërlidhës për paaftësitë (disability liaison officer) (këta në disa raste quhen për shkurt ONI (DLO))

- Ky person punon në burg. Ata janë në burg që të ndihmojnë të burgosurit të cilët kanë paaftësi.
- Ju mund të kërkonti që të takoheni me ta në çdo kohë. Kërkojini personelit që t'ju ndihmojë ta bëni nëse keni nevojë.
- Ju mund të flisni me oficerin ndërlidhës për paaftësitë rreth çdo ndihme që ju nevojitet dhe që ka të bëjë me paaftësinë tuaj ose gjëra të cilat i keni vështirë t'i bëni.

3

Doktorët ose infermieret (personat nga kujdesi për shëndetin)

- Ju mund të flisni me ta rreth çdo problemi që keni me shëndetin. Ose nëse ndiheni i shqetësuar ose i mërziur

✓ **Kërkojini personelit të burgut t'ju ndihmojë në çdo kohë që keni nevojë.**

✓ **Thuajini personelit të burgut nëse e keni të vështirë t'i bëni gjërat. Ata duhet t'ju japin ndihmën që ju nevojitet.**

Çfarë mund të bëni nëse

1

Ndiheni i mërziur apo i shqetësuar rreth diçkaje. Apo nëse dikush ju trajton keq

Është **shumë e rëndësishme** që ju t'i thoni dikujt për këtë.

Mund të flisni me

- çdo anëtar të personelit
- një doktor apo infermiere
- një dëgjues ose një mik. Këta janë të burgosur të tjerë të cilët janë aty që t'ju ndihmojnë nëse jeni të mërziur apo shqetësuar. Ata në disa raste veshin një bluzë pa mëngë të veçantë.
- oficeri ndërlidhës i paaftësive
- një kapelan (ky është një person që ka të bëjë me besimin. Por ju nuk keni nevojë të jeni besimtar që të flisni me kapelanin)
- persona jashtë burgut të quajtur **Samaritanë (Samaritans)**. Ata gjenden në çdo kohë që të ndihmojnë personat që janë të mërziur dhe të shqetësuar. Ju mund t'i telefononi në numrin 08457 90 90 90.

Çfarë mund të bëni nëse

2

E keni të vështirë ta kuptoni informacionin ose atë që ju thonë njerëzit

Personeli i burgut duhet

- t'ju ndihmojë që ta kuptoni informacionin
- t'ju japë informacion në një mënyrë të thjeshtë për ju.

Ju mund të flisni me çdonjërin nga personeli i burgut që

- t'jua thotë gjërat në mënyrë të thjeshtuar
- t'ju japë informacion në një mënyrë tjetër, si për shembull me fjalë të thjeshta me ilustrime apo në CD
- t'jua lexojnë gjërat. Ose t'ju ndihmojnë që të kuptoni gjërat të tilla si formularë apo letra
- personeli në bibliotekë gjithashtu është në gjendje t'ju ndihmojë të merrni informacion i cili është i thjeshtë që ta kuptoni

3

E keni të vështirë t'i bëni gjërat në burg sepse keni një problem shëndetësor ose paaftësi

Mund të flisni me

- një oficer burgu
- oficerin ndërlidhës për paaftësitë
- në disa burgje, ka të burgosur të tjerë të cilët mund të ndihmojnë të burgosurit me paaftësi.

Ata në disa raste veshin një bluzë të veçantë.

Personeli i burgut duhet të bëjë gjithçka të mundur që t'i bëjë gjërat më të thjeshta për ju.

Çfarë duhet bërë nëse

4

Nuk jeni të kënaqur me diçka ose mendoni se burgu ka bërë diçka të gabuar

- Pyesni personelin e burgut se ç'duhet bërë nëse nuk jeni të kënaqur me diçka në burg. Ndoshta të burgosurit e tjerë mund të jenë në gjendje t'ju ndihmojnë
- Mund t'ju duhet të plotësoni një formular për të thënë se me çfarë nuk jeni të kënaqur. Mund të kërkonit ndihmë që ta plotësoni formularin.
- Nëse doni të thoni diçka tejet private ju mund të plotësoni një formular të quajtur formulari i **mënyrës së fshehtë (confidential access)**.
- Ka persona jashtë burgut të quajtur **Bordi i Pavarur i Mbikëqyrjes (Independent Monitoring Board (IMB))**. Ju mund të kërkonit që të flisni me ta nëse keni probleme në burg
- Nëse ata nuk mund t'ju zgjidhin problemin, ju mund t'i shkruani dikujt të quajtur **Avokati i Popullit për Burgjet dhe Lirimin me Kusht (Prisons and Probation Ombudsman)** në këtë adresë
Prisons and Probation Ombudsman
Ashley House
2 Monck Street
London SW1P 2BQ

Nëse nuk jeni të kënaqur me kujdesin për shëndetin që merrni

- Flisni së pari me dikë nga kujdesi për shëndetin për të parë nëse mund ta zgjidhni këtë problem
- Nëse personeli i kujdesit për shëndetin nuk mund ta zgjidhë problemin, mund të merrni ndihmë nga një grup jashtë burgut të quajtur **Shërbimi i Pavarur Mbështetës për Ankesat (ICAS)**
- Ju mund ta merrni numrin e telefonit të ICAS nga personeli i burgut, biblioteka ose duke telefonuar personat të quajtur NHS Direct në numrin **0845 4647**

5

Ndiheni i sëmurë apo duhet të merrni ilaçe

Nëse jeni sëmur ose keni probleme me sytë ose dhëmbët

- Kërkoni që të vizitoheni tek doktori, infermierja, dentisti ose okulisti
- Nëse nuk e merrni dot ndihmën që kërkoni në burg, personeli do të vendosë se cila do të ishte gjëja më e mirë për t'u bërë
- **Nëse duhet të merrni ilaçe**
 - thuajini personelit të burgut se duhet të merrni ilaçe
 - një doktor në burg do t'ju japë ilaçet që ju duhen
 - mund të keni mundësinë që ilaçet t'i mbani në qelinë tuaj. Personeli i burgut do t'ju informojë.

Gjëra të tjera me të cilat mund të keni nevojë për ndihmë

Mund të gjeni më shumë informacion rreth këtyre gjërave në librin e gjatë.

Gjykimet

(Nëse thyni rregullat e burgut mund t'ju duhet të shkoni në një gjykim. Kjo është kur ju shkoni të flisni rreth asaj që ka ndodhur).

- Guvernatori ose personeli i burgut duhet t'ju ndihmojnë të kuptoni se çfarë po ndodh.
- Mund të lejoheni të merrni dikë me vete nëse nuk kuptoni.
- Thuajini guvernatorit nëse keni thyer një rregull sepse nuk e kuptuat.
- Avokati juaj mund t'ju ndihmojë.

Qelia

Qelia juaj ose personi me të cilën ndani qelinë

- Flisni me personelin e burgut nëse keni probleme me qelinë ose me personin me të cilin ndali qelinë.

Ushqimi

- Thuajini doktorit ose infermieres nëse nuk mund t'i hani disa nga ushqimet.
- Burgu do t'ju gatuajë ushqim të veçantë nëse doktori dhe infermierja e miratojnë.

- Pyesni personelin e burgut nëse keni nevojë të zgjidhni ushqimin.

Formularët

- Personeli i burgut duhet t'ju japë ndihmën që kërkonti për të plotësuar formularët.
- Mund t'ju ndihmojnë edhe të burgosurit e tjerë.

Paratë dhe kompensimet

- Thuajini personelit të burgut nëse keni nevojë për para ose kompensime. Ata do t'ju thonë se kush mund t'ju ndihmojë.
- Ju duhet të njoftoni vendin nga ku i merrni kompensimet që ju tani jeni në burg.

Rregullat

- Personeli i burgut duhet t'ju japë informacion rreth rregullave. Kërkojuni atyre t'ju shpjegojnë rregullat që nuk kuptoni.

Kontrollet

(kur personeli bën kontroll në trupin tuaj)

- Thuajini personelit të burgut nëse e keni të vështirë kur ju bëjnë kontroll për shkak të paaftësisë tuaj ose të një problemi të shëndetit.
- Personeli i burgut do të gjejë mënyrën më të mirë për të bërë kontrollin.

Plani i dënimit

- Oficeri juaj personal ose menaxheri i dënimeve duhet t'ju japin të gjithëve ndihmën që ju nevojitet.

Vizitat nga miqtë dhe familja

- Personeli i burgut duhet t'ju japë të gjithë ndihmën që ju nevojitet për vizitorët ose që të mbaheni në kontakt me njerëzit.

Puna dhe edukimi

- Thuajini personelit të burgut ose oficerit ndërlidhës për paaftësitë nëse puna ose edukimi ju duken të vështira.
- Ata duhet të bëjnë gjithçka munden që t'ju ndihmojnë të bëni punën ose edukimin (edukimi është kur ju mësoni gjëra të reja).

Jeta pas burgut

- Personeli i burgut mund t'ju ndihmojë të përgatiteni për jetën pas burgut.

Gjërat që duhet të sqaroni përpara se të largoheni nga burgu

Kompensimet

- Ju mund të aplikoni për kompensime tek Zyra e Punës (Jobcentre Plus).
- Kërkojini personelit të grupit të rivendosjes që t'ju ndihmojë.

Doktori

- Kërkojini personelit të grupit të kujdesit për shëndetin t'ju ndihmojë të gjeni një doktor jashtë burgut.

Ndihmë e përgjithshme për jetën pas burgut

- Mund t'ju duhet të kontaktoni punonjësit e shërbimeve sociale në zonën në të cilën do të jetoni.
Ose këtë gjë mund ta bëjnë miqtë ose familja për ju.
- Mund t'i kërkonit grupit të rivendosjes ose grupit të kujdesit për shëndetin që t'ju ndihmojë ta bëni këtë gjë. Ata mund t'ju thonë për çdo kënd tjetër i cili mund t'ju ndihmojë pasi të largoheni.

Strehimi (nëse nuk keni se ku të jetoni)

- Pyesni grupin e rivendosjes që t'ju ndihmojë.
- Ose burgu juaj mund të ketë persona të posaçëm që mund të flasim me ju rreth vendeve se ku mund të jetoni jashtë burgut.

Licenca

(Nëse dënimi juaj është më i gjatë se një vit, ju duhet të ndiqni disa rregulla kur dilni nga burgu. Këto rregulla quhen **licenca**.)

- Një person i quajtur **menaxheri i të dënuarve (offender manager)** do të sigurohet që ju i kuptoni dhe i ndiqni rregullat. Ata mund t'ju ndihmojnë edhe me gjëra të tjera.

Puna, kurset e trajnimit ose të edukimit

- Pyesni personelin nga grupi i edukimit ose grupi i rivendosjes që t'ju ndihmojë të gjeni punë ose trajnim pasi të dilni nga burgju.

Easy words by Mencap.

Prison Reform Trust 15 Northburgh Street London EC1V OJR
Telephone: 020 7251 5070
Email: prt@prisonreformtrust.org.uk www.prisonreformtrust.org.uk
Registered Charity No: 1035525 Company Limited by Guarantee:
2906362